

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 27 JANAR 2022

E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot diskutojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KfW-së, për rehabilitimin me eficiencë energjetike të konvikteve studentore të universiteteve publike në Shqipëri”. Po, dakord, ne në vazhdimësi kemi marrë kredi për vepra të ndryshme publike, por sot kemi detyrimin të ndajmë demagogjinë nga e vërteta për gjendjen në të cilën ndodhet arsimi sot dhe se sa pak mbështetet ai nga buxheti i shtetit. Po ju citoj raportin më të fundit të UNICEF-it: mungesa e investimeve në arsim dhe tek të rinjtë, po largon të rinjtë drejt emigracionit. Studimi i UNICEF-it tregon mjaft qartë se fëmijët dhe prindërit e shohin emigracionin si zgjedhjen e vetme. Vendimi i pothuajse 60 % të maturanëve për të studiuar jashtë vendit pasqyron jo vetëm vlerësimin që kanë lidhur me perspektivat e tyre ekonomike, por edhe sistemin arsimor kombëtar.

Shpenzimet publike për arsimin arritën në vetëm 3, 4 për qind të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2020, që është shumë më pak se mesatarja e rajonit dhe e Bashkimit Europian, e cila është 5.4% e prodhimit të brendshëm bruto. Pse? Sepse arsimi nuk është prioritet për këtë qeveri, e cila nuk alokon buxhet për investime në infrastrukturë, për rritjen e pagës së mësuesve dhe pedagogëve, për përmirësimin e kurrikulave apo të cilësisë së mësimdhënies. Studentët dhe nxënësit që na ndjekin sot nga ekrani, e prekin çdo ditë këtë realitet: pa ngrohje në klasat dhe auditorët e tyre, gjë që u dëshmuar shumë qartë para disa ditësh, kur u mor vendimi për të mbyllur shkollat, duke dëshmuar dështimin e të gjitha inaugurimeve dhe të propagandës së kësaj qeverie. Në vitin 2022, nxënësit tanë detyrohen të mësojnë me xhupa e të shkruajnë me dorashka në mes të dimrit. Studentët tanë studiojnë pa laboratorë, pa infrastrukturë mbështetëse për të avancuar dijen e tyre, shumë larg standardeve të Bashkimit Europian, por dhe standardeve të rajonit, në qoftë se doni t’u referohemi. Kjo maxhorancë kishte shumë merak, që në buxhetin e 2022 të alokonte fonde për PPP-të, për oligarkët, për të paguar inceneratorët dhe jo për të rritur buxhetin për arsimin në 5 % të prodhimit të brendshëm bruto.

Studentët përballen sot jo vetëm me mungesën e infrastrukturës arsimore, por mbi të gjitha me një kosto jetese të papërbalueshme; me prindër që vuajnë çdo ditë papunësinë, vuajnë rritjen e çmimeve të produkteve të shportës, të karburanteve, e që sakrifikojnë çdo gjë për të edukuar fëmijët e tyre. Por gjithë kjo sakrificë e prindërve shqiptarë për shkollim, nuk shkon dhe nuk shpërblehet me punësim. Këtë nuk e them unë, por e thotë raporti më i fundit i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), që nxjerr në pah një tjetër plagë që sa vjen e po thellohet. Papunësia në Shqipëri është tipar i njerëzve të shkolluar, ndryshe nga rajoni, ndryshe nga Bashkimi Europian. Raporti tregon se 70 % e të papunëve në Shqipëri janë me universitet, janë me arsim të lartë, dhe ky është trishtim i madh. ILO vë në dukje se shumë njerëz bëjnë punë që nuk përputhen me nivelin e tyre arsimor. Ky studim dëshmon mjaft qartë dështimin e sistemit arsimor në Shqipëri, që nuk përputhet me kërkesat e tregut të punës, dëshmon paaftësinë e qeverisë për të garantuar kushte për zhvillim ekonomik, punësim të sigurt, të mirëpaguar e në përputhje me edukimin e qytetarëve. Pa dyshim, papunësia ka rritur në mënyrë dramatike emigracionin, që sot është shndërruar në fatkeqësi kombëtare të shpopullimit.

Propagandës me rritje ekonomike imagjinare i ka dalë boja, ngaqë shqiptarët e dinë, se e jetojnë çdo ditë realitetin me të cilin duhet të përballen. Nëse pyesim sot studentët shqiptarë, 90 % e tyre duan të ikin nga vendi për të ndërtuar të ardhmen e tyre gjetkë, në Gjermani apo në vendet e tjera europiane, ku mjekët tanë, infermierët tanë, që nga fillimet e studimit, gjithë synimin dhe strategjinë e tyre e kanë për të emigruar, për të shkuar në një vend tjetër. Pse? Sepse ky vend nuk ka arritur t'u sigurojë paga dinjitoze, nuk ka arritur t'u mundësojë një vend të sigurt, i cili të mund të funksionojë në bazë të meritës dhe dijes e jo nëpërmjet klientëve pranë qeverisë. Ne duhet të dëgjojmë me shumë kujdes dhe të reflektojmë, sidomos pas protestës së para dy vjetëve që bënë studentët, të cilët me të drejtë u ngritën për të drejtat e tyre, që shkelen çdo ditë, për të kuptuar revoltën e tyre ndaj padrejtësive që u ndodhin çdo ditë në këtë vend. Prandaj, sot është një kampanë alarmi për të gjithë ne, për të ardhmen e të rinjve tanë. Ne duhet ta kthejmë arsimin në prioritet kombëtar, pasi investimi në edukim është e vetmja mënyrë për të zhvilluar ekonominë, për të ndaluar shpopullimin, për të rikthyer shpresën në këtë vend, që mund të ecet me dituri, mbi bazën e meritës dhe të konkurrencës. Nëse nuk veprojmë sot me tërë fuqinë tonë, të rinjtë do t'ju refuzojnë masivisht, duke zgjedhur të largohen nga vendi ku ata do të dëshironin të jetonin dhe të ndërtonin të ardhmen e tyre, por që kjo qeveri ua pamundësoi, duke mbajtur këtë përgjegjësi historike. Faleminderit!